



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:250023

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05631868

**PKR.nr.70/2024**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Alban Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.R, për shkak të veprës Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe A.B për shkak të veprës penale Posedimi, i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.248/23 të datës 28.03.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 05.04.2024, në të cilën kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë **29.04.2024** përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### Të akuzuarit:

**I. B.R**, nga i ati A. dhe nëna I., e gjinisë T., i lindur më ..., në Prishtinë, me adresë banimi në Prishtinë ..., me nr. personal ..., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendje së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit nga data 15.11.2023 deri më datën 05.04.2024.

**II. A.B**, nga i ati F. dhe nëna I., e gjinisë M., i lindur më ..., në Prishtinë, me adresë banimi në ... në Prishtinë, me numër personal ..., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### JANË FAJTORË

#### I

I akuzuari B.R, është fajtor për shkak se pa autorizim ka poseduar substanca apo preparate, te cilat janë shpallur me ligj si narkotike, substanca psikotrope, analoge, me qëllim të shitjes, kështu që me datë me dt.15.11.2023, rreth orës 19:15, në lagjen Ulpiana në Prishtinë, i dyshuari i ka shitur 2 qese me substancë narkotike të dyshuarit A.B, dhe me pas gjatë kontrollës nga ana e zyrtarëve policorë, në lagjen Dardania e kanë takuar të dyshuarin B. të cilit në veturën të tipit "Golf 6" ngjyrë e vishnje, me targa ... , i janë gjetur 1 qese me substancë narkotike të llojit

marihuanë me peshë 1.3 gram, të cilën ia kanë konfiskuar, ndërsa gjatë bastisjes në banesën e të dyshuarit B. kanë gjetur dy qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 960.73 gram, një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë 65 gram, një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 28.30 gram, si dhe 1 peshore digjitale, të cilat pas ekzaminimit u vërtetua që janë të llojit marihuanë,-,-

Me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së.

## II

I akuzuari B.R, është fajtor për shkak se me datën 15.11.2023, rreth orës 19:15, gjatë bastisjes nga ana e Policisë në shtëpinë e të dyshuarit B.R në rr. “Lekë Dukagjini” në Dardani në Prishtinë, i është gjetur dhe konfiskuar një armë e tipit “Zoraki” 91Z-T, një karikator dhe një fishek me mbishkrim PPU, të cilën e mbante pa autorizim,-

Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

## III

I akuzuari A.B, është fajtor për shkak se në të njëjtën ditë vend dhe kohë si në dispozitivin I të aktakuzës, pa autorizim ka poseduar narkotik substanca psikotrope dhe analoge, të cilat i ka blerë nga i dyshuari B.R, kështu që pjesëtarët e policisë gjatë kontrollit të veturës të tipit “Audi A3” ngjyrë e zezë, me targa ..., ia kanë gjetur 3 qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 3.68 gram, të cilat i janë konfiskuar dhe të njëjtat pas ekzaminimit ka rezultuar se janë të llojit marihuanë,-

Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi, i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Andaj konform neneve 7, 17, 21, 38, 42, 43, 69, 70, 76 dhe 79 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 449 dhe 462 të akuzuarit:

## I GJYKON

**I.** Të akuzuarit B.R për veprën penale nga dispozitivi I i këtij Aktgjykimi, i shqipton **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite**, në këtë dënim të shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në paraburgim, prej datës 15.11.2023 deri me datë 05.04.2024 dhe **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **5,000 (pesëmijë) Euro**. Ndërsa për veprën penale nga dispozitivi II i këtij Aktgjykimi i shqipton **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **1,000 (njëmijë) Euro**.

Konform nenit 76 par.2 pika 2.4 të KPRK-së:

Të pandehurit B.R i cakton **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite** i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe **DËNIM UNIK ME GJOBË** në shumë prej **6,000 (gjashtëmijë) Euro**, të cilin dënim me gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

**II.** Të akuzuarit A.B për veprën penale nga dispozitivi III i këtij Aktgjykimi, i shqipton **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** i cili dënim do të ekzekutohet pas

plotfuqishmërisë në afat prej 15 ditësh së këtij aktgjykimi dhe **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **1,000 (njëmijë) Euro**, të cilin dënim me gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënimin me burgim, njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.

**URDHËR - URDHËROHET** konfiskimi i përhershëm i sendeve si në vijim: një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 1.3 gram, dy qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 960.73 gram, një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë 65 gram, një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 28.30 gram, 1 peshore digjitale, një armë e tipit “Zoraki” 91Z-T dhe 3 qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 3.68 gram, të cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, këto sende duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Obligohen të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e procedurës secili veç e veç dhe atë për paushallin gjyqësor shumë prej pesëdhjetë (50) €, në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave të paguajë shumë prej pesëdhjetë (50) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë /Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë nën shenjën PP.I.nr.248/23 të datës 28.03.2024, ndaj të akuzuarve B.R, për shkak të veprës Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe A.B për shkak të veprës penale Posedimi, i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 05.04.2024 ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, gjatë së cilës seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, gjykata të akuzuarve ia dha mundësin për ta pranuar fajësinë apo të deklarohen të pafajshëm.

Të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, deklaruan se e kanë kuptuar aktakuzën në tërësi dhe me vullnet të plotë dhe të vetëdijshëm, për pasojat e pranimit të fajësisë, e kanë pranuar në tërësi fajësinë për veprat penale e cila iu vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit, si dhe janë penduar, i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra penale.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, ka deklaruar se: pranimi i fajësisë është në përputhje me provat me të cilat është ngritur aktakuza dhe pranimi është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre si dhe është i mbështetur në dispozita ligjore.

Mbrojtësja e të akuzuarit B.R, av. Mentor Neziri lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj ka deklaruar se: e mbështes deklarimin e të mbrojturit tim i cili e pranoni fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, pranimin e fajësisë e bën pas konsultimit të mjaftueshëm me mua lidhur me pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë, si dhe pranimi i fajësisë mbështet edhe në provat materiale dhe personale që i përmban aktakuza andaj gjykatës i propozojmë që ta aprovon pranimin e fajësisë, gjykatës i propozojmë që si rrethana lehtësuese të merr për baze pranimin e fajësisë pendimin për kryerjen e veprave penale, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, qëndrimin shumë korrekt të tij gjatë gjithë procedurës, të merr për bazë moshën e tij të re, për fat të mirë nga kryerja e këtyre veprave penale nuk kemi dëme materiale dhe as dëme jo materiale, ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese të merr për baze faktin se i akuzuari B. e ka gjendjen shume të rëndë shëndetësorë sepse pak muaj para se të arrestohej e ka pasur ne operim të rëndë në mushkri dhe ka qëndruar për një kohë në spital dhe i është referuar nga mjekët të përdor terapi të vazhdueshme dhe të del në ajër të pastër dhe qëndrimi në masën e paraburgimit të njëjtit ju ka keqësuar gjendjen shëndetësore ku gjatë qëndrimit në paraburgim disa here i është ofruar tretman mjekësorë duke iu ofruar tretman mjekësor si dhe pompën e inhalimit dhe për këtë gjykatës i derzojm edhe raporte mjekësore krejtësisht në fund meqenëse kanë pushuar shkaqet ligjore për të cilat i është vazhduar masa e paraburgimit gjykatës i propozojmë që të njëjti të ndërprite masa e paraburgimit dhe duke marr rrethanat lehtësuese të cekura më lart të njëjtit të shqipton një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B, av. Halit Shaliani, lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij ka deklaruar se: e mbështesim pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im e që konsiderojmë se ky pranim është bërë konform dispozitave ligjore dhe pas konsultimit me mua si mbrojtës, andaj gjykatës i propozojmë që të aprovon pranimin e fajësisë po qeshe gjykata e aprovon këtë pranim propozojmë që të merr në konsiderim rregullat e përgjithshme për matjen dhe zbutjen e dënimit duke potencuar rrethanat në të cilat është kryer vepra, mosha e personit, bashkëpunimi i përgjithshëm i të njëjtit në fazën e hetimeve e po ashtu edhe tani pranimin e fajit, keqardhjen e shfaqur nga i njëjti e po ashtu edhe sjelljen e tij pas kësaj ngjarje që tani me i njëjti edhe nuk është përdorues u substancës narkotike, duke marr parasysh çështjet e potencuar më lart gjykatës i propozojmë që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysh këto rrethana dhe të shqiptoj një dënim sa më të butë sepse edhe me vete pohimin e tij që tani me nuk është përdorues i substancës narkotike konsiderojmë veç se është arritur qëllimi i dënimit.

Meqë të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi paraprakisht janë njoftuar nga gjykata, me benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i cili është bërë vullnetarisht, pranimi i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjukata vlerësoi se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 242 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të pandehurve për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj veprë penale dhe të njëjten edhe e ka aprovuar, pasi që pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, ashtu që nuk ka administruar asnjë provë për të vërtetuar gjendjen faktike.

Nga pranimi i fajësisë nga të akuzuarit, në shqyrtimin fillestar u vërtetua se me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tyre, kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Pranimi i fajësisë, po ashtu gjen mbështetje, në shkresat e lëndës siç janë: deklarata e dëshmitarëve: G.R, A.SH dhe A.B, vërtetimet mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve, me numër R-2023XI-DKKO-HTN-PR-236, i datës 15.11.2023, raporti i ekspertizës i Agjencisë

Kosovare për Forenzikë, me numër AKF/2023-3726/23-3640, i dt. 08.03.2023, raporti i ekspertizës i Agjencisë Kosovare për Forenzikë, me numër AKF/2023-3727/23-3569, i dt. 15.02.2024, si dhe nga evidencat për të kaluarën kriminale, nga të cilat rezulton se në veprimet e të akuzuarve formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së, veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale Posedimi, i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Nga paragrafi par.2 të nenit 267 të KPRK-së, është parashikuar forma themelore e kryerjes së veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së, sipas së cilës dispozitë është paraparë se këtë vepër e kryen: “Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet”. Nga paragrafi par.1 të nenit 366 të KPRK-së, është parashikuar forma themelore e kryerjes së veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, sipas së cilës dispozitë është paraparë se këtë vepër e kryen: “Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”.

Nga paragrafi par.1 të nenit 269 të KPRK-së, është parashikuar forma themelore e kryerjes së veprës penale, Posedimi, i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, sipas së cilës dispozitë është paraparë se këtë vepër e kryen: “Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet”.

Ndërsa, nga pranimi i fajësisë nga të pandehurit, këto pranime gjejnë mbështetje edhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, del se në veprimet e të pandehurve manifestohen të gjitha elementet e veprave penale të lartcekura.

Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, gjykata i ka shpallur fajtor të akuzuarit, për shkak të veprave penale që i vihen në barrë, ngase me veprimet e të njëjtëve konsumohen të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat janë edhe penalisht përgjegjës.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarit, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, andaj si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të akuzuarit mori faktin se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë, derisa si rrethanë lehtësuese gjithashtu vlerësoi, pendimin e thellë dhe shprehjen e keqardhjes para gjykatës për kryerjen e veprave penale, premtimin e tyre se në të ardhmen nuk do të përsërisin asnjëherë këto veprime, ndërsa si rrethanë rënduese ndaj të njëjtëve gjykata gjeti mënyrën si i kanë kryer veprat penale, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarve në kryerjen e veprave penale dhe se të njëjtit kanë qenë të dënuar më parë sipas evidencës penale të gjykatës me aktgjykime të plotfuqishme, i akuzuari B.R ka qenë i gjykuar sipas aktgjykimit nën shenjë P.nr.691/16, P.nr.605/22 dhe P.nr.154/22, ndërsa i akuzuari A.B ka qenë i gjykuar sipas aktgjykimit nën shenjë 2022:106952, P.nr.175/20 dhe P.nr.1461/23 për vepra të njëjta të kësaj natyre. Andaj gjykata duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura, i shqiptoj dënim të paraparë me ligj dhe sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij

aktgjykimi, me bindje se ky sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarve dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit komfor nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar, u mor konform nenit 79 par.1 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin, u mor në bazë të neneve 267 par.5, 269 par.3 dhe 366 par.3 të KPRK-së si dhe nenit 276 par.1 dhe par.2, pika 2.4 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarve, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë konform nenit 449 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 39 par 3, pika 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 05/L036).

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.70/2024, datë 29.04.2024**

**G j y q t a r i**

---

Alban Ajvazi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.